



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR

TIRANË

Njoftim

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ka regjistruar P.p.nr.6759 viti. 2021 për veprën penale të të parashikuar nga neni 180 i K.Penal.

Ky Procedim penal është hetuar në unitet me P.p.nr.8390 viti 2021 për veprën penale "Tregëtim dhe transportim të mallrave që janë kontrabandë" "Ruajtja dhe depozitimi i mallrave kontrabandë" parashikuar nga nenet 178/1,179/1, të K.Penal ku nën drejtimin e Prokurorit Bledar Valikaj, janë kryer veprime të plota hetimore duke përfshirë dhe metodat speciale të hetimit duke finalizuar mëngjesin e datës 23.11.2021 operacionin e koduar "FAST DELIVERY", në kuadër të të cilit u bë arrestimi i disa shtetasve dhe me pas u moren në përgjegjësi penale bashkë me disa subjekte tregtare që ofronin shërbimin privat postar, duke zberthyer një skemë të magazinimit dhe tregëtimit të mallrave kontrabandë, skemë që i ka shkaktuar dëm të konsiderueshme financiarë shtetit.

Nga hetimet filimisht janë administruar informacionet të marra në rrugë operative dhe procedurale nga ana e policisë gjyqësore të Seksionit për Krimin Ekonomik e Financiar pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë për disa subjekte që krijojnë dyshime se duke shfrytëzuar porositjen në rrugë virtuale dhe të pakotrollueshme nga organet tatimore, dhe me pas duke shfrytëzuar mënyrën e speditimit me shërbimin privat, tregëtojnë në mënyrë të paligjshme produkte të ndryshme të dyshuara kontrabandë apo produkte për të cilat nuk deklarohet shitje dhe për rrjedhojë nuk i faturohen me kuponë tatimor klientit final. PO kështu disa prej këtyre subjekteve dyshohet të jenë të pa regjistruar në organin Tatimore dhe QKB), si dhe nga informacionet e para të marra në rrugë operative dhe konkretisht në informacionin e datës 16.08.2021 me nr.protokollin 12657/1 nga AKEP (Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare) është përcjellë informacioni dhe shqetesimi mbi kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë të disa ofruesve të shërbimeve postare. Nga kontrolli i ushtruar janë konstatuar subjekte tregëtare të cilat ushtrojnë aktivitet informal, nëpërmjet rrjeteve sociale Instagram, Fcb etj. Pikërisht për këto fakte të renditura më sipër, por edhe nga diktimi aktual për shkak të "Covid 2019" u krijua një terren shumë i favorshëm dhe treg i pakotrolluar i tregtisë online duke bërë që shumë subjekte dhe persona fizikë të operojnë online duke abuzuar me mos pagimin e detyrimeve fiskale, dhe duke i shkaktuar kështu dëm të konsiderueshme financiare të shtetit.

Për këtë fakt janë bërë kqyrjet e llogarive online në rrjetet sociale si Instagram dhe Facebook me të dhëna kryesisht mbi veshjet (brande dhe firma të ndryshme) dhe produkte të higjienës personale. Këto produkte në disa prej rasteve shiten me çmim më të lartë se produkti origjinal ose në raste të tjera kanë çmim më të ulët duke lënë dyshime të arsyeshme për mënyrën e futjes së këtyre produkteve në treg apo cilësinë dhe origjinalitetin e tyre.

Në vijim të veprimeve hetimore nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, bazuar mbi informacionet të njejtës natyre është filluar P.p.nr.8390 viti 2021 për veprën penale "Tregëtim dhe transportim të mallrave që janë kontrabandë" "Ruajtja dhe depozitimi i mallrave kontrabandë" parashikuar nga nenet 178/1,179/1, të K.Penal procedim I cili është dërguar për gjykim nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Në kuadër të P.p.nr.8390 viti 2021 është kryer kontroll në bashkëpunim edhe me inspektorët e tatimeve në subjekte të ndryshme që operojnë në fushën e dërgesave postare ku janë konstatuar pako postare në sasi të konsiderueshme me vlera të ndryshme dhe pashoqëruar me kuponë tatimor të cilat janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale

Në këto subjekte janë gjetur sasi malli të konsiderueshme gati për tu dërguar tek klientet me mallra të ndryshme të pashoqëruara me asnjë dokumentacion doganor apo tatimor dhe dyshohet të jenë mallra të futura kontrabandë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Mbas verifikimit në subjekt dhe dorëzimit të listës së klientëve nga subjekti në sistemin Deepsee dhe nga kqyrja e QKB është bërë mundur identifikimi i subjekteve.

Në kategorinë e faqeve të evidentuara gjatë procesit hetimor disa prej tyre janë subjekte që shesin mallrat e shtrenjta duke i cilësuar si brande dhe të dyshuara si subjekte që shmangin regjimin doganor. Pjesa tjetër e subjekteve janë faqe të cilat shesin mallra me çmim më të lirë të dyshuar me destinacion hyrës Turqinë dhe disa prej tyre imitacion të markave të njohura sportive kjo e pare dhe me çmimet që ato shfaqin në faqen e tyre.

Në vijim është verifikuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave ku për të gjithë individët apo shtetasit e poshtëshënuar të kemi një përgjigje nëse kanë kryer ose jo zhdoganime gjatë 3 viteve të fundit dhe pjesa me e madhe e subjekteve të kontrolluara nuk ka kryer procedura doganore importi dhe eksporti për periudhën 01.01.2019-31.12.2021 duke ngritur dyshimin e arsyeshëm që këto subjekte importonin mallra kontrabandë dhe me pas i tregtonin nëpërmjet tregtisë së pakotrolluar online dhe perfundonin që t'i dërgonin tek porositësit duke përdorur shërbimet postare private.

Në vijim te hetimeve janë kqyrur perseri pakot e evidentuara te subjekteve te permenduar me siper në subjektet postare të cilat kanë qënë në ruajtje pranë subjekteve përkatëse.

Nga verifikimi në këto subjekte ka rezultuar se në subjektin postar **Bipex** per subjektet të cilat kanë qënë pa kupon tatimor janë hapur sërish kutitë postare per tu verifikuar dhe ka rezultuar se mallrat e gateshme te ketyre subjekteve, gati per tu derguar ne destinacionet perkatese kanë qënë pa kupon tatimor apo dokumentacion doganor bashkangjitur si me poshte:

- London Fashion
- Subjekti King Bro Style
- Subjekti Pure Parfume
- Subjekti Klodi Store
- Subjekti Bli Veshje
- Subjekti Jaguar

Në subjektin postar **Mc.Courrier** per subjektet të cilat kanë qënë pa kupon tatimor janë hapur sërish kutitë postare per tu verifikuar dhe ka rezultuar se mallrat e gateshme te ketyre subjekteve, gati per tu derguar ne destinacionet perkatese kanë qënë pa kupon tatimor apo dokumentacion doganor bashkangjitur si me poshte:

- Subjekti Becool
- Subjekti Natura Therapy

Në subjektin postar **Coex** per subjektet të cilat kanë qënë pa kupon tatimor janë hapur sërish kutitë postare per tu verifikuar dhe ka rezultuar se mallrat e gateshme te ketyre subjekteve, gati per tu derguara ne destinacionet perkatese kanë qënë pa kupon tatimor apo dokumentacion doganor bashkangjitur si me poshte

- Subjekti Zero Absolute
- Subjekti Garderoba
- Subjekti Outlet Shoes
- Subjekti TutoCasa.
- Subjekti HM Original
- Subjekti Chic& Posch Uk
- Subjekti Dars. Al
- Subjekti Pelinku Store
- Subjekti Carpet Diem.
- Subjekti Divino Shoes

Në subjektin postar **Adex** per subjektet të cilat kanë qënë pa kupon tatimor janë hapur sërish kutitë postare per tu verifikuar dhe ka rezultuar se mallrat e gateshme te ketyre subjekteve, gati per tu derguara ne destinacionet perkatese kanë qënë pa kupon tatimor apo dokumentacion doganor bashkangjitur si me poshte

Graal

Fansi Shop

Emy Shop

LuxModa

Në subjektin postar **Intex** per subjektet të cilat kanë qënë pa kupon tatimor janë hapur sërish kutitë postare per tu verifikuar dhe ka rezultuar se mallrat e gateshme te ketyre subjekteve, gati per tu derguara ne destinacionet perkatese kanë qënë pa kupon tatimor apo dokumentacion doganor bashkangjitur si me poshte

Suna Sport

Non solo moda

Golden Shoes

Tendencia e modes

Në subjektin postar **Ideal Express** per subjektet të cilat kanë qënë pa kupon tatimor janë hapur sërish kutitë postare per tu verifikuar dhe ka rezultuar se mallrat e gateshme te ketyre subjekteve, gati per tu derguara ne destinacionet perkatese kanë qënë pa kupon tatimor apo dokumentacion doganor bashkangjitur si me poshte

Veshje per femije reisa

Shopping girls

Anais

Original brands albania

EOX store

Me procesverbal kqyrje nga ana jonë është bërë kqyrje e faqeve të subjekteve online në faqen e Instagramit dhe te rrjeteve te tjera sociale si dhe jane perdorur teknika te tjera hetimore duke arritur identifikimin e personave qe posedonin keto faqe online dhe qe tregonin mallrat e dyshuara kontrabande.

Për të gjitha subjektet për të cilat është bërë evidentimi nga ana jonë është bërë evidentimi i tyre në sistemet e Deepsee, Tims dhe QKB për ato subjekte që kanë pasur dhe janë përshkruar të detajuara në faqen në vijim.

Ndaj shtetasve të identifikuar nga ana jonë nëpërmjet kqyrje marrjes së emrave të subjekteve të dorëzuara nga vetë subjekti, kërkimi në sistemet e Policisë u bë i mundur identifikimi i disa prej shtetasve.

Për pjesën tjetër të cilët nuk kanë arritur të identifikohen dhe për faqet e tjera që operojnë online do kryhen veprime të metjshme hetimore me qëllim identifikimin e subjekteve dhe vendodhjen e magazinave të tyre.

Sa me lart rezultot që ekziston dyshimi I arsyeshem I bazuar ne prova qe subjekte te ndryshme, duke perdorur rrjetet sociale reklamojne mallra te cilat fillimisht futen teresisht ose pjeserisht kontrabande ne territorin e Republikes se Shqiperise duke shmangur keshtu pagimin e detyrimeve doganore dhe me pas I tregtojne duke I derguar ne destinacionet e porositesve nepermjet sherbimeve postare pa I pajisur me faturat apo kuponat fiskale duke shmangur keshtu detyrimet tatimore dhe shkakuar rrjedhimisht nje dem ekonomik shume te madh shtetit si edhe duke deformuar konkurrencen dhe tregtine e ndershme.

Mekanizmi I kesaj veprimtarie kriminale ne fushen e doganave dhe tatimeve kryhet nepermjet operimit me faqe reklamimi dhe tregtimi online dhe dorezimi me ane te sherbimeve postare private, veprime keto qe e bejne pothuajse te pamundur gjurmimin dhe kontrollin tatimor pasi keto subjekte nuk kane nje adrese fikse fizike ushtrimi te aktivitetit qe do te bente te mundur mbajtjen nen kontroll tatimor te veprimtarise se tyre ekonomike.

Kjo veprimtari ekonomike ne kundershitim me ligjin aktualisht duke perfituar edhe nga situata e imponuar Covid 19 e cila me karantinimin e detyruar te popullsisë ka bere qe si fenomen te marre permasa te gjera duke zevendesuar ne nje shkalle shume te madhe tregtine fikse ne njesi sherbimi dhe duke bere keshtu qe buxheti I shtetit per pesoje humbje te konsiderueshme nga mospagimi si I detyrimeve doganore ashtu edhe I detyrimeve tatimore.

Nje veprimtari e tille kriminale kryhet se pari ne kurriz dhe me nje dem shume te madh ekonomik financave shterore, se dyti deformon konkurrencen e ndershme me subjekte tregtare te cilat importojne dhe tregtojne mallra duke respektuar legjislacionin doganor dhe tatimor ne fuqi dhe se treti ne dem te vete konsumatoreve pasi mallrat e tregtuara duke qene kontrabande nuk jane te certifikuara per origjinalitetin cilesor te tyre.

Pra ne kete rast, nga gjithë veprimtaria hetimore rezultoi qe keto subjekte realizojne nje perfitim ekonomik ne menyere te kundraligjshme, duke nje veprimtari me rrezikshmeri per vete maredheniet juridike qe thyen, duke kryer veprime ne shperfillje totale te rregullave te vendosura nga legjislacioni tatimor dhe ai doganor, duke thyer rregullat e konkuresces se ndershme te subjekteve te cilat realisht respektojne cdo detyrim fiskal dhe ne fund duke mashtruar edhe vete konsumatorin me shitjen e produkteve te pacertifikuar per origjinen dhe cilesine.

Per gjithë kete arsytim eshte detyre e Prokurorise ushtrimi I ndjekjes penale dhe nderprerja e kesaj veprimtarie te paligjshme duke vene para pergjegjesise penale autoret dhe duke dhene mesazhin e parandalimit te kryerjes se nje veprimtarie te tille ne kohen e metejshme

Pra keto subjekte duhet te hetohen pasi veprimet e tyre plotesojne teresisht elementet e figurave te veprave penale të “Kontrabandë me mallra të tjerë”, “Fshehje të ardhurash”, “Mospagim taksash dhe tatimesh” të parashikuar nga nenet 174,180,181.

Për këto arsye, bazuar dhe në nenet 287/1 e 315 të Kodit të Procedurës Penale u krye regjistrimi i emrit të personit që I atribuohet vepra penale e “Kontrabandë me mallra të tjerë”, “Fshehje të ardhurash”, “Mospagim taksash dhe tatimesh” të parashikuar nga nenet 174,180,181.

1. A H administrator i dy faqeve Online London Fashion dhe Bo Boo Fashion
2. E I administratore tek subjekti Pure Perfume
3. K V administrator i subjektit Klodi Store
4. E K administrator i faqes King Bro Style
5. J Q administrator i faqes Bli Veshje
6. A S administrator i faqes online Jaguar kids
7. P Rr administratore e faqes Gral
8. E K administratore e faqes Fansi Shop
9. E Xh administratore e faqes EMY SHOP
10. E R administratore e faqes Luxmoda
11. M B administrator i faqes online Zero Absolute
12. A D administratore e faqes Garderoba ime
13. G Ll administrator i faqes Outlet Shoes
14. I D administrator i faqes Tutto casa.al
15. M G administratore e faqes HM Original Fashion
16. J K administratore e dy faqeve online Chic&Posh Uk dhe Lulita.Uk
17. S R administratore e faqes online Dars.Al
18. Sh P administrator i faqes Pelinku Store dhe subjekt fizik Shkëlqim Pelinku
19. B B administrator i faqes Carpet Diem
20. R Gj administratore e faqes Divino Shoes
21. E Ç administrator i faqes online BeCool
22. E Z S administratore e faqes online Natura Vita Health

Ndaj ketyre shtetasve u kerkua Caktimi i masave te sigurise ‘‘arrest ne burg’’

Nga ana e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane u pranua kerkesa e Prokurorit per caktimin e masave te sigurimit arrest ne burg ndaj ketyre shtetasve.

Ne bashkepunim me Seksionin e Luftes Kunder Krimet Ekonomik dhe Financiar ne DVP Tirane po vijohet me ekzekutimin e Udherit te Ekzekutimit te arrestit te nxjerre nga Prokurori Bledar Valikaj

Ne vijim ne bashkepunim me Seksionin e Luftes Kunder Krimet Ekonomik dhe Financiar ne DVP Tirane do kryhen veprime te tjera per te dokumentuar veprimtarine kriminale te ketyre shtetasve, si dhe per te dokumentuar dhe evidentuar edhe subjektet te tjera qe kryejne veprimtari te tille duke i shkaktuar deme te konsiderueshme financave te shtetit me qellim goditjen e gjithë kesaj veprimtarie te paligjshme ne kurriz te shtetit, qytetareve por edhe ne dem te konkureses se ndershme.

[shqiptarja.com]